Telekomi i Kosovës SH. A.
Kosovo Telecom J. S. C.
Telekom Kosovo D. D.
Nr./No./Br. 01- 2343/20
Data/Date/Datum 02-09/20
PRISHTINË, PRISTINA, PRIŠTINA

vala KOSOVO TELECOM

# SHPREHJE INTERESI

Telekomi i Kosove Sh.a., shpreh interesin e saj për të marr pjese në "Thirrje për Aplikim sipas skemës së garantëve për Financimin e Infrastrukturës Dixhitale", të publikuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me datë 25 gusht 2020, si njëra nga komponentët e Projektit të Ekonomisë Dixhitale të Kosovës (KODE). Për të realizuar pjesëmarrjen në skemën e garantëve të lartcekur, TK SH.A ka nevoje për partner ose nënkontraktor, të cilët do ishin në gjendje të ofronin kryerjen e disa punimeve/furnizimeve/shërbimeve që nuk mund të realizoheshin nga TK Sh.A.

Projekti KODE financohet nga Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA), dhe informata me të detajuara për projektin mund të gjenden në https://kodeproject.org

Telekomi i Kosovës sh.a në cilësinë e operatorit ekonomik, përmes këtij publikimi fton të gjithë operatoret ekonomik potencial për bashkëpunim të mundshëm që do kenë cilësinë e nënkontraktonit.

Për tu bërë partner i Telekomit, operatoret ekonomik fillimisht duhet të plotësojnë disa kushte, si:

- Duhet të dorëzojnë Certifikatën e Regjistrimit te Biznesit (Kopje)
- Te dorëzojnë listën e referencave për punët/furnizimet apo shërbimet e kryera ne fushën e telekomunikacionit me theks në ndërtime e rrjetave optike.
- Listën e personelit në dispozicion për realizim të projektit.
- Vërtetimin e Administratës Tatimore, që nuk është në vonese të pagesës se tatimeve
- Certifikatën nga Gjykata Themelore, që nuk është në procedure të falimentimit dhe likuidimit.

Përzgjedhja e nënkontraktorëve do të bëhet duke pas parasysh plotësimin e kërkesave të mësipërme, si dhe seriozitetin e kompanisë që aplikon, ku përparësi do kenë kompanitë të cilat kane punuar për Telekomin në të kaluarën.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen përmes e-mail adresës në vijim: KODE@kosovotelecom.com, ndërsa për pyetje apo sqarime eventuale mundë të drejtoheni gjithashtu në KODE@kosovotelecom.com

Afati i fundit për dorëzim te aplikacioneve është data; 07.09.2020, në ora 24:00.

Vetëm aplikantët që i plotësojnë kushtet dhe konsiderohen të përshtatshëm do të ftohen për diskutuar lidhur me mundësitë e ftesës për bashkëpunim të mëtutjeshëm me Telekomin e Kosovës në këtë projekt.

Telekomi i Kosovës SH.A.

U.D. Kryeshefi Ekzekutiv, Zeqir Kiqina

Prishtinë 02 Shtator 2020

Telekomi i Kosovës SH. A.
PRISHTINË
PRISHTINA
PRIŠTINA
Kosovo Telecom, J. S. C.
Telekom Kosovo D. D.